

DEMOKRACIA NA BASHKON



DEMOKRACIA ËSHTË LIRA JONË


ELISONA (14), LAURENT (15), BLERTA (14), DIAR (14)



Demokracia po ndërtohet nga populli. Se si është duke ndërtuar demokracia, do ta shohim në artikullin më poshtë

Të dashur lexues të kësaj gazete, me kënaqësi iu njoftojmë se demokracia çdo ditë e më shumë është duke u ndërtuar. Ndërtimi i saj është duke u bërë në baza individuale dhe grupore, që për qëllim kanë zhvillimin e shtetit tonë demokratik. Ky ndërtim është duke u realizuar nga secili qytetar i Republikës së Kosovës, përmes pjesëmarrjes aktive dhe edukimit qytetar. Tërë këtë aktivizim qytetar e ka mundësuar sistemi më i mirë i qeverisjes, që është demokracia. Këtë sistem e fuqizojnë disa elemente përbërëse të tij, të cilat janë: liria, respekti, toleranca, solidariteti, e drejta e të shprehurit lirshëm, etj.

Ne jemi fatlum që jetojmë në një shtet demokratik, sepse i gëzojmë të gjitha këto elemente dhe kemi mundësi që të kontribuojmë edhe më shumë për një të ardhme sa më të ndritur.



Barazia i jep vlerë sistemit demokratik

Siç e dijmë, demokracia për herë të parë është shfaqur në Greqi në vitin 507 p.e.s. Në atë kohë nuk kishte demokraci të plotësuar, për arsye se të drejtën e votës e kishin vetëm burrat e pasur. Por, me kalimin e viteve gjërat kanë ndryshuar. Ky ndryshim ishte në të mirën tonë, sepse kur trajtohem në mënyrë të barabartë ne ndihemi të lumtur dhe të gëzuar. Prandaj, qytetarë të dashur, vazhdoni të punoni për vendin tuaj dhe kundesni sa më shumë për sistemin demokratik.



Sistem i paqes dhe tolerancës



Shtetin demokratik e ndërtojmë ne

PËR NJË SHTET MË TË MIRË

SELIM (14), LORIK (13), DJELLONA (14), DILLORESA (14)


E ardhmja e popullit varet nga ne. Ne jemi ata, të cilët mundohemi për një shtet më të mirë. Se pse është e rëndësishme të kontribuojmë për vendin tonë, lexojeni artikullin

Ne çdo ditë bëjmë zgjedhje të ndryshme p.sh. zgjedhim se çfarë të veshim, çfarë të luajmë, çfarë të hajmë, etj. Por, janë disa zgjedhje tepër të rëndësishme të cilat ndikojnë tërë popullin. Këto zgjedhje njihen si zgjedhjet shtetërore, ku mund të marrin pjesë të gjithë ata qytetarë, të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare. Është e caktuar moshë 18 vjeçare, sepse në këtë moshë jemi më të pjekur dhe jemi më përgjegjës për veprimet tona. Për arsye se kështu ndërtohet shteti demokratik, kërkohet përgjegjësi dhe përkushtim për të votuar.


Shteti ynë Kosova ka dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet qendrore dhe ato lokale. Në zgjedhjet qendrore, zgjedhen deputetët, të cilët do ta përfaqësojnë popullin. Ndërsa, në zgjedhjet lokale, zgjedhen kryetarët e komunave përkatëse dhe asambleistët. Ju ftojme edhe juve që të votoni, sepse kështu ndërtohet shteti demokratik.



Përmes votës, zgjedhen përfaqësuesit e popullit



Të gjithë e kanë të drejtën për të votuar



Vendvotimet gjithmonë janë të përcaktuara




Votuesit e së ardhmes



Përfaqësuesit e popullit gjithsej në numër janë 120

NE JEMI UDHËHEQËSIT E KËTIJ VENDI

GRETA (14), YLLZA (15), VLERA (14), FLAKTRIM (13), ARLIND (14), BLERON (15), MEDIHATE (15)



Ne edhe pse fëmijë, kemi vendosur që ta shkruajmë një artikull për një temë të veçantë e cila është Ndarja e Pushtetit. Ju urojmë lexim të këndshëm

Këtë artikull duam ta fillojmë duke iu treguar se ç'është demokracia. Ajo është mënyrë e udhëheqjes, në të cilën pushtetin e ka populli. Por, si mund të udhëheqin gati 2 milionë qytetarë në një vend si Kosova? Këta qytetarë dalin, votojnë dhe i zgjedhin deputetët. Deputetët, të cilët gjithsej janë 120, punojnë në Kuvendin e Kosovës. Detyra e tyre e parë është t'i përfaqësojnë interesat e qytetarëve. Pastaj, detyra tjetër e tyre është të miratojnë ligjet. Ky institucion përfaqëson Pushtetin Legjislativ. Pikërisht, fjala legjislativ do të thotë *ligjbërës* apo *ligjvënës*. Por, çfarë ndodh me ligjet pasi ato të miratohen? Pas këtij procesi të rëndësishëm ato dërgohen në Qeveri, ku dhe ekzekutohen. Qeveria është institucion, i cili paraqet Pushtetin Ekzekutiv. Ajo drejtohet nga Kryeministri, i cili bashkëpunon me ministrat. Disa nga ministrat e Qeverisë janë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, etj. Këto dy institucione edhe pse bëjnë punë të ndryshme, Kuvendi prapëseprapë ka për detyrë të kontrollojë punën e Qeverisë, duke iu parashtruar pyetje ministrave të caktuar. Ata detyrohen sipas Kushtetutës së Kosovës t'iu përgjigjen këtyre pyetjeve. Ligjet që miratohen dhe ekzekutohen janë themeli i punës së

Gjykatës, e cila merr vendimet e saj në bazë të këtyre ligjeve. Gjykatat përfaqësojnë Pushtetin Gjyqësor. Ato ndahen në tri lloje: në Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme.



Të tri këto institucione edhe pse kanë përgjegjësi të ndara janë të barabarta dhe janë të lidhura ndërmjet vete. Ngjashëm sikur tri degët e Fizikës. Secila ka drejtime dhe studion gjëra të ndryshme, por ato kanë balancim në mes vete. Në këtë mënyrë drejtohet edhe shteti ynë, Kosova. Ne të gjithë duam që ta forcojmë edhe më tej këtë vend!



Të gjitha institucionet duhet ta respektojnë ligjin


RËNDËSIA E LIGJEVE NË JETËN TONË

FORTESA (13), RREZARTA (14), GENTUART (14), GERTA (14), ENIS (14), ALBINA (13)



Institucion që miraton ligje, institucion që kontrollon Qeverinë dhe që përfaqëson popullin. Por, kush është ky institucion?

Sot kur u zgjuam në mëngjes, të gjithë ne nxënësit e klasës IX-2 ishim shumë të lumtur. E dinim se sot do të marrim pjesë në punëtorinë e demokracisë „Demos-ti“. Pasi erdhëm dhe u prezantuam, u ndamë në



na duhen dhe që duam t'i lexojmë. Por, kush e thotë këtë? Këtë e thotë ligji për bibliotekat. Sipas këtij ligji, të gjithë ne, qytetarët jemi të barabartë dhe kemi të drejtë të përdorim librat e bibliotekave publike. Mirëpo, nga ka ardhur ky ligj? Ky ligj ka ardhur pikërisht nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Deputetët, të cilët punojnë aty kanë për detyrë të miratojnë ligje. Ata miratojnë ligje për të rregulluar jetën tonë. Kjo detyrë e Kuvendit, njihet si funksioni legjislativ. Funksion tjetër i Kuvendit është funksioni kontrollues, sepse Kuvendi kontrollon Qeverinë nëse ajo është duke i zbatuar ligjet. Si dhe funksioni i fundit është funksioni përfaqësues, sepse deputetët na përfaqësojnë neve, qytetarëve në Kuvend. Pra, Kuvendi ka rëndësi të madhe në jetën tonë. Kuvendi është shtëpia jonë. Çdo vendim i marrë aty është vendim që ndryshon edhe prek jetërat e gjithë neve qytetarëve.

grupe. Grupi ynë si temë diskutimi kishte Kuvendin. Emër ky i njohur dhe shumë i dëgjuar nga ne. Sigurisht se ne gjithmonë e kemi ditur rëndësinë që ka Kuvendi në jetën tonë. Megjithatë, informatat që i morëm dhe diskutimi që e bëmë në grup na bëri të kuptojmë që vërtet gjithçka që ndodh në Kuvend ka ndikim të madh në jetërat e të gjithë neve. Ne si nxënës kemi mundësi të shkojmë në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës (apo në çdo bibliotekë tjetër publike) dhe aty lirshëm mund të marrim librat që



Autorët punëtorë të këtij artikulli



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Halil Alidema“
Klasa: IX-2
Vendi: Pozheran, Viti